



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 176/3 Prot

Tiranë, më 05.10.2020

V E N D I M

Nr.110, datë 05.10.2020

Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të kërkesës me nr. 176/1 prot., datë 15.7.2020, të nëpunësit ***, në lidhje me përfundimin e afatit të transferimit të përkohshëm dhe rivendosjen e gjëndjes së ligjshmërisë.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes,

Vërej se:

Nëpërmjet kërkesës të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 176/1, datë 15.7.2020, nëpunësi doganor *****, me emërim të përhershëm në pozicionin “Doganier në Zyrën e Operacioneve Doganore”, në Degën Doganore Vlorë, ka parashtruar pretendimin se, afati i transferimit të përkohshëm të tij në pozicionin, “Doganier në Zyrën Doganore të Terminalit Bregdetar për Depozitimin e Naftës dhe Nënprodukteve në Gjirin e Vlorës”, në Degën Doganore Vlorë, ka përfunduar, por megjithatë, nga ana e strukturave përgjegjëse, nuk është ndërmarrë asnjë veprim për rikthimin e tij në pozicionin e mëpërshtëm të punës.

Nga tërësia e dokumentacionit të administruar për këtë rast, konstatohet se nëpunësi në fjalë me aktin nr. 30987 prot., datë 17.12.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, “Për transferim të përkohshëm në detyrë”, për nevoja të institucionit, është transferuar

përkohësisht në pozicionin *“Doganier në Zyrën Doganore të Terminalit Bregdetar për Depozitimin e Naftës dhe Nënprodukteve në Gjirin e Vlorës”*, në Degën Doganore Vlorë.

Rezulton që nëpunësi në fjalë, nëpërmjet kërkesës të regjistruar me nr. 1769 prot., datë 19.12.2019, ka njohur Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me pretendimin e se transferimi i tij i përkohshëm në pozicionin *“Doganier në Zyrën Doganore të Terminalit Bregdetar për Depozitimin e Naftës dhe Nënprodukteve në Gjirin e Vlorës”*, në Degën Doganore Vlorë, është i padrejtë, sepse pas ristrukturimit të institucionit, ai ka marrë emërim të përhershëm në pozicionin *“Doganier në Zyrën e Operacioneve Doganore”*, në Degën Doganore Vlorë.

Pas verifikimit të këtij rasti, në analizë të fakteve dhe të akteve ligjore, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me aktin nr. 176 prot., datë 10.2.2020, ka njoftuar nëpunësin *****, se transferimi i përkohshëm i tij në pozicionin, *“Doganier në Zyrën Doganore të Terminalit Bregdetar për Depozitimin e Naftës dhe Nënprodukteve në Gjirin e Vlorës”*, në Degën Doganore Vlorë, është bërë në përputhje me përcaktimet që parashikon ligji në lidhje me transferimin e përkohshëm të punonjësve doganorë dhe për këtë arsye, si dhe duke qenë brenda afateve ligjore që parashikon ligji për transferimin e përkohshëm, ka vendosur arkivimin e çështjes.

Pas kësaj, në datën 15.07.2020, ai i ka paraqitur një kërkesë tjetër Komisionerit (regjistruar me nr. 176/I prot.), në të cilën bën me dije që, afati i transferimit të përkohshëm ka përfunduar që në datën 19.6.2020 dhe që megjithëse pas këtij momenti i është drejtuar institucionit zyrtarisht për rikthim në vendin e mëparshëm të punës, institucioni ka kthyer një përgjigje (Shkresa nr. 9945/I prot., datë 5.6.2020, *“Kthim përgjigje”*, e DPD), nëpërmjet të cilës struktura përgjegjëse, ka informuar se po bëhen përpjekje dhe në rastin më të parë të mundshëm, do të njoftohet për plotësimin e kërkesës së tij, por pavarësisht kohës së kaluar, nuk është kryer asnjë veprim tjetër.

Duke analizuar situatën si më sipër, në kushtet kur afati i transferimit të përkohshëm është tejkaluar dhe nëpunësi në fjalë nuk është kthyer në pozicionin e mëparshëm të punës, është vepruar në shkëlqje të pikës 7/c, të nenit 15, të Kodit Doganor, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur: *“Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte transferuar”* dhe meqënëse nuk kemi të bëjmë me ndonjë rast përjashtimor të parashikuar në ligjin e posaçëm, ky punonjës duhej të ishte rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, pa kushte.

Në të njejtën kohë, do të ishte e drejtë që pas kësaj, të mbahet parasysh që, qoftë ky nëpunës, ashtu dhe nëpunësit e tjerë doganorë mund të transferohen për një afat tjetër, në vazhdim apo me përsëritje, vetëm në kushtet e ekzistencës së nevojës së domosdoshme të argumentuar, duke përcaktuar saktë afatet dhe duke mbajtur parasysh parimet e proporcionalitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, parashikuar përkatësisht në nenet 12 e 17, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e punës “Doganier në Zyrën e Operacioneve Doganore”, në Degën Doganore Vlorë, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është tejkaluar afati maksimal 6-mujor i transferimit, parashikuar në pikën 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ka detyrimin të krijojë kushtet e nevojshme dhe të ndjekë procesin e zbatimit të këtij vendimi.
3. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit

civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

6. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha